

Vendim nr. 263 datë 22.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 22.10.2025 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 5 (N) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: NDUE ZEFI, përfaqësuar nga avokat Baftjar Rusi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. (11-2020-5683) 617, datë 01.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 10-2021-1108 (194), datë 21.06.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2024-2072, datë 17.12.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 27, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 e vijues të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 23.02.2019 kërkuesi ka debatuar në një lokal me një shtetas. Ky i fundit, së bashku me të birin e mitur 10-vjeçar është larguar me automjet. Kërkuesi ka qëlluar me armë zjarri (automatik kallashnikov) në drejtim të automjetit, duke shkaktuar vdekjen e atij shtetasi, ndërsa i mituri ka shpëtuar. Për këtë ngjarje, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (*Prokuroria e Durrësit*) ka regjistruar procedimin penal nr. 404 të vitit 2019 dhe në përfundim të hetimeve paraprahe ka kërkuar në gjykatë dërgimin e çështjes në gjyq, duke e akuzuar kërkuesin për veprat penale të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese dhe të mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit, të parashikuara nga nenet 79, shkronja “ë” dhe 278, paragrafi 1, të Kodit Penal (KP).

2. Në seancën paraprahe kërkuesi ka paraqitur tri kërkesa: (i) gjykimin e shkurtuar të çështjes; (ii) pavlefshmërinë e procesverbalit të marrjes në pyetje të viktimës së mitur, me argumentin se pyetja e tij ishte bërë në kundërshtim me nenin 361/a, pikat 1 e 4, të Kodit të Procedurës Penale (KPP); (iii) ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese në atë të vrasjes me dashje, të parashikuar nga neni 76 i KP-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 354, datë 12.06.2020, ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq, duke rrëzuar kërkesat për pavlefshmërinë e pyetjes të të miturit dhe për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, si dhe duke u shprehur se kërkesa për gjykimin e shkurtuar do të shqyrtohej nga trupi gjykues që do të gjykonte çështjen në themel.

3. Gjatë gjykimit të çështjes kërkuesi i ka përsëritur kërkesat e tij, të cilat nuk janë pranuar. Në përfundim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2020-5683) 617, datë 01.12.2020, ka vendosur deklarin fajtor të kërkuesit, sipas akuzave të ngritura nga prokuroria, dhe dënimin e tij me 30 vjet burgim. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 10-2021-1108 (194), datë 21.06.2021, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2072, datë 17.12.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit.

4. Në datën 03.09.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimet gjyqësore i janë cenuar:

5.1. *E drejta për të mos u dënuar pa ligj*, e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, si rrjedhojë rrëzimit nga gjykatat të kërkesës për gjykim të shkurtuar, në interpretim të gabuar të nenit 403, pika 2, të KPP-së, duke cenuar edhe parimin *in dubio pro reo* e të drejtën e mbrojtjes. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet për cilësimin juridik të veprës penale dhe vendndodhjen e të miturit në momentin e qitjes.

5.2. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

5.2.1. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjykatat nuk kanë vlerësuar në mënyrë objektive provat e paraqitura, si dhe nuk kanë marrë në konsideratë pretendimet për cilësimin juridik të veprës penale.

5.2.2. *Parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit*, pasi gjykatat kanë mbështetur vendimin e tyre kryesisht në provat e paraqitura nga organi i akuzës. Ato nuk kanë marrë në konsideratë provat e paraqitura nga mbrojtja, të cilat vërtetonin vendndodhjen e të miturit dhe faktin se vrasja është kryer në grindje e sipër, pasi kërkuesi është provokuar nga viktima.

5.2.3. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm për pretendimet e kërkuesit lidhur me pyetjen e të miturit, si dhe për individualizimin e dënimit. Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar për shkaqet e parashtruara në rekurs.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

6. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë

të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkueshin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

8. Në çështjen konkrete, Kolegji çmon të ndalet në analizën e legjitimitimit *ratione materiae*. Në këtë drejtim, kërkuesi ka pretenduar se vendimet gjyqësore i kanë cenuar të drejtën për të mos u dënuar pa ligj dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor (në aspektet e gjykatës së paanshme, barazisë së armëve dhe arsyetimit të vendimit gjyqësor). Këto të drejta garantohen respektivisht nga nenet 29 dhe 42 të Kushtetutës, pra *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohen në vijim.

9. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës për të mos u dënuar pa ligj, kërkuesi ka argumentuar se gjykatat e zakonshme nuk i kanë ulur atij dënimin penal, duke i refuzuar kërkesën për gjykim të shkurtuar me anë të interpretimit arbitrar të nenit 403 të KPP-së dhe vlerësimit të gabuar të provave. Në këtë drejtim, gjykatat duhej të kishin marrë parasysh pretendimet për cilësimin juridik të veprës penale dhe vendndodhjen e të miturit në momentin e qitjes. Sipas tij, vepra penale e vrasjes duhej cilësuar si vrasje me dashje e parashikuar nga neni 76 i KP-së, që nuk parashikon dënim me burgim të përjetshëm, ndaj ndalimi i gjyqimit të shkurtuar që parashikon neni 403 i KPP-së nuk ishte i zbatueshëm për të.

10. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për të mos u dënuar pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*) përbën element thelbësor të shtetit të së drejtës. Ajo duhet të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimin arbitrar (*shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023; nr. 16, datë 15.06.2009; nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur është pretenduar cenimi i kësaj të drejte për shkak të refuzimit të kërkesës për gjykimin e shkurtuar, Gjykata ka evidentuar se ai lloj gjykimi nuk

realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit dhe në rast se ai ka dyshime mbi këtë vlerësim, kjo mjafton që të rrëzojë kërkesën e të pandehurit (shih vendimet nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 6, datë 26.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese).

11. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se zbatimi i ligjit dhe vlerësimi i provave është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm. Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që e bën të padrejtë gjykimin (shih vendimet nr. 42, datë 29.05.2024; nr. 9, datë 27.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

12. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë nuk e ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar, me arsyetimin se kërkuesi akuzohej, ndër të tjera, edhe për veprën penale të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese, për të cilën neni 79, shkronja “ë”, i KP-së parashikon edhe dënim me burgim të përjetshëm, ndaj për këtë arsye dhe në bazë të nenit 403, pika 2, të KPP-së, gjykimi i shkurtuar nuk mund të pranohej. Po kështu, ajo gjykatë ka vlerësuar se nuk qëndron pretendimi i kërkuesit për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale në atë të vrasjes me dashje, pasi nga provat e shqyrtuara rezultonte se kërkuesi kishte qëlluar me armë zjarri drejt automjetit ku ndodhej viktimja dhe fëmija i tij i mitur. Në përfundim, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar rrethanat konkrete të çështjes dhe e ka deklaruar fajtor kërkuesin për të dyja akuzat e ngritura nga prokuroria, si dhe e ka dënuar përfundimisht me 30 vjet burgim.

13. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, e cila ka vlerësuar se qëndrimi ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj, duke evidentuar përmes një analize të hollësishme të provave se akuzat në ngarkim të kërkuesit provoheshin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Sipas asaj gjykate, kërkuesi me dashje direkte kishte shkaktuar vdekjen e viktimës dhe me dashje indirekte kishte vënë në rrezik serioz jetën e fëmijës së mitur të viktimës, por pasoja ndaj këtij të fundit nuk kishte ardhur për shkak të rastësisë.

14. Në vijim, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se arsyetimi i gjykatave të faktit ishte i drejtë. Sipas Gjykatës së Lartë, neni 403, paragrafi i dytë, i KPP-së ndalon gjykimin e shkurtuar në çdo rast kur i pandehuri akuzohet për një vepër penale për të cilën ligji parashikon dënim me burgim të përjetshëm. Ndalimi ligjor nuk lidhet me masën e dënimit përfundimtar që cakton gjykata por

gjen zbatim në çdo rast që të pandehurit i atribuohet njëra nga veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm, qëndrim ky i konsoliduar edhe me vendimin njëses të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të datës 04.07.2024. Po sipas Gjykatës së Lartë, pretendimet e kërkuarit për cilësimin juridik të veprës penale, përveçse kishin marrë përgjigje nga gjykatat e faktit, ishin edhe haptazi të pabazuara, pasi neni 79, shkronja “ë”, i KP-së nuk kërkon ardhjen e pasojës (vdekjen e më shumë se një personi), por mjafton që vepra të jetë kryer duke vënë në rrezik jetën e shumë personave, pavarësisht nëse për pasojat subjekti i veprës penale ka ose jo dashje direkte.

15. Nga analiza e vendimeve të gjykatave të zakonshme, Kolegji vëren se ato kanë shqyrtuar dhe i kanë dhënë përgjigje pretendimit të kërkuarit për cenimin e të drejtës për të mos u dënuar pa ligj, duke paraqitur arsyet faktike dhe ligjore përse kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk mund të pranohej. Gjykatat e faktit kanë vlerësuar provat dhe kanë konkluduar për cilësimin juridik të veprës penale, duke zbatuar më pas nenin 403 të KPP-së të lidhur me nenin 79, shkronjë “ë”, të KP-së, ndërsa Gjykata e Lartë ka arsyetuar për kuptimin e ligjit – nenit 403 të KPP-së, për rastet se kur gjykimi i shkurtuar është i ndaluar. Në vlerësimin e Kolegjit, nuk rezulton që çmuarja e provave ose zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme të ketë gabime faktike apo ligjore të dukshme, që t’i bëjë vendimet gjyqësore arbitrare. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e të drejtës për të mos u dënuar pa ligj është haptazi i pabazuar.

16. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe të parimit të barazisë së armëve*, kërkuari ka parashtruar se gjykatat nuk kanë vlerësuar në mënyrë objektive provat e paraqitura. Mirëpo, siç është pohuar në mënyrë konstante në jurisprudencën kushtetuese, mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë situatë, Kolegji çmon se ky pretendim i kërkuarit nuk mund të merret në shqyrtim për sa kohë ai ka të bëjë me mënyrën e vlerësimit të provave.

17. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, kërkuari ka parashtruar se gjykatat nuk kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme për pretendimet e tij për pavlefshmërinë e deklarimeve të dëshmitarit të mitur, sipas nenit 361/a, pika 4, të KPP-së, i cili kërkon regjistrimin audioviziv të deklarimeve të të miturit dhe dhënien e pëlqimit nga kërkuari e mbrojtësi i tij për përdorimin e tyre si provë, si dhe nuk kanë marrë në konsideratë rrethanat lehtësuese në caktimin e dënimit.

18. Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se i mituri ndodhej jashtë vendit, ndaj ka lejuar leximin e deklarimeve të dhëna gjatë hetimeve paraprake. Po kështu, ajo i ka dhënë përgjigje edhe pretendimit të kërkuarit, duke u shprehur se pyetja e të miturit ishte bërë të nesërmen e ngjarjes, duke i krijuar një ambient miqësor në prani të prindit, psikologut e mbrojtësit ligjor, pra në përputhje me nenet 361/a të KPP-së e 39 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ndërsa regjistrimi i dëshmisë, përveçse nuk kërkohej në çdo rast, mbetej në mundësitë që kishte organi procedues. Ky arsyetim është gjetur i drejtë nga gjykata e apelit, e cila i ka dhënë përgjigje edhe pretendimit të kërkuarit në ankim për rrethanat lehtësuese në caktimin e dënimit. Qëndrimi i gjykatave të faktit është vlerësuar i drejtë nga Gjykata e Lartë, madje kjo e fundit ka vënë në dukje se fakti që deklaratimet e viktimës së mitur nuk janë regjistruar me mjete audiovizive, nuk përbën shkak për pavlefshmërinë e procesverbalit të marrjes në pyetje. Sipas Gjykatës së Lartë, neni 58/a i KPP-së parashikon se regjistrimi i bisedës me të miturin viktimë nëpërmjet mjeteve audiovizive bëhet kur është e mundur dhe e përshtatshme dhe lidhet me mbrojtjen e integritetit psikologjik të të miturit, që do të thotë shmangien nga ripyetja e tij, çka rezulton edhe nga përmbajtja e nenit 361/a, pika 4, të KPP-së. Pra, dispozita ligjore nuk kërkon detyrimisht regjistrimin me mjete audiovizive, por mund të bëhet edhe me shkrim të dokumentuar në procesverbal, sikurse ka ndodhur në rastin konkret (*shih faqet 17-18 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

20. Në analizë të vendimmarrjeve të mësipërme, Kolegji çmon se, në kundërshtim nga sa ka argumentuar kërkuari, gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme për pretendimet e tij për pavlefshmërinë e deklaratimeve të dëshmitarit të mitur, sipas nenit 361/a, pika 4, të KPP-së dhe individualizimin e dënimit. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

21. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.